

LITERATURE OF ALBANIANS IN AMERICA AND ITS INTEGRATION IN NATIONWIDE LITERATURE

Besim MUHADRI

University of Gjakova „Fehmi Agani“, Faculty of Philology, Albanian Literature
besim.muhadri@uni-gjk.org, besimmuhadri@yahoo.com

UDC 821.18-054.72 (73)

Conference paper

Abstract

The persistence of Albanians in the United States dates back to the late 19th century. Over the years, respectively in the first decade of the twentieth century, the Albanian community reaches a number of considerations and, as such, finds it reasonable to make various political and cultural arrangements. In 1909 we published the newspaper „Dielli“ and in that same year the formation of the pan-Albanian organization „Vatra“, which became a powerful voice of the Albanians not only in America, but also the people who lived in the homeland.

In addition to the publication of different newspapers, we also have the development of a literature that was widely used by those rare Albanian literature-makers. This was expanded in the field of translation of different works from English into Albanian language etc. In the thirties and forties of the 20th century, Albanians in America were more organized and also more confident, therefore in the field of literature, to evolve in the postwar world after the emigration of prominent Albanian intellectuals, not only in politics, but also in the field of literature and culture in general.

After the 90s of the twentieth century we have a flood of Albanians to the USA, and on this occasion many of the writers affirmed in the homeland, who today constitute a well-organized community, both within the Association of Albanian-American Writers, and in other cultural and literary organizations. The literature that is being developed there today by Albanians is a literature that needs to focus on analyzing and seeing the size of its evolution as well as its integration into the nationwide literature.

Key words: *Literature of Albanians in America, „Dielli“ newspaper, nationwide integration.*

Përmblehdje

Ngulmimet e shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës datojnë që nga fundi i shekullit XIX. Ma kalimin e viteve, përkatësisht në dekadën e parë të shekullit XX, bashkësia shqiptare arrin në një numër të konsideruar dhe, si e tillë, e pa të arsyeshme që të bëjë organizime të ndryshme, qoftë politike, qoftë edhe kulturore. Në vitin 1909 kemi botimin e gazetës „Dielli“ dhe në po atë vit edhe formimin e orgagizatës pansonshqiptare „Vatra“, e cila u bë një zë i fuqishëm i shqiptarëve jo vetëm në Amerikë, por edhe i tayre që jetonin në atdhe.

Krahas botimit të gazetave të ndryshme, kemi edhe zhvillimin e një letërsie që lërohet kryesisht nga ata shqiptarë të rrallë që merreshin me letërsi. Me kalimin e viteve, kjo u zgjerua edhe në fushën e përkthimit të veprave të ndryshme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe etj. Në vitet tridhjetë dhe dyzet të shekullit XX shqiptarët në Amerikë i shohim më të organizuar por edhe më të konstituar, prandaj edhe në fushën e letërsisë, për të evoluar në vitet e pasluftës së Dytë Botërore, pas emigrimit të intelektualëve të shquar shqiptarë, jo vetëm politikë, por edhe të fushës së letërsisë e të kulturës në përgjithësi.

Pas viteve 90 të shekullit XX kemi një „vërshim“ të shqiptarëve për në SHBA, e me këtë rast edhe të shumë shkrimitarëve të afirmuar në atdhe, të cilët sot përbëjnë një bashkësi të organizuar mirë, qoftë brenda Shoqatës së Shkrimitarëve Shqiptaro-amerikanë, qoftë edhe në organizma të tjera kulturore e letrarë. Letërsia që zhvillohet sot nga shqiptarët atje është një letërsi që duhet drejtuar vëmendjen për ta analizuar e për të parë përmasën e evoluimit të saj si dhe të integrimit të saj edhe në letërsinë mbarëkombetare.

Në shkrimin tonë do të mundohemi të trajtojmë disa aspekte të kësaj natyre, për të parë stadin e zhvillimit të letërsisë së shqiptarëve që jetojnë dhe krijojnë në SHBA.

Fjalët kyçë: *Letërsia e shqiptarëve të Amerikës, gazeta „Dielli”, integrimi mbarëkombëtar.*

Hyrje

Letërsia shqipe është një letërsi, e cila, për shkak të rr Ethanave historike dhe politike të kohës, lindi dhe u zhvillua për një kohë të gjatë edhe jashtë territorit shqiptar. Emigrimet e shqiptarëve, qoftë për arsy politike, qoftë ekonomike, në vazhdimësi kanë qenë të theksuara, ndërkaq, me kalimin e kohës, përvèc të tjerash, emigrantët shqiptarë u morën edhe me aktivitete kulturore dhe letrare. Kështu ndodhi edhe me shqiptarët të cilët emigruan në SHBA, fillimet e të cilët emigrim i hasim në pjesën e dytë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Kur jemi te letërsia dhe shkrimtarët shqiptarë të cilët një pjesë të madhe të veprimtarisë së tyre letrare, kulturore dhe jetësore e zhvilluan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës,¹ atëherë pa dyshim se ndër të parët duhet të përmendim Fan S. Nolin, i cili në këtë vend qëndroi një kohë të gjatë, madje atje dhe ndërroi jetë, pastaj Fik Konicën, Sotir Pecin, Qemal Panaritin, etj.

Këta i takojnë brezit të shqiptarëve, prandaj edhe të krijuesve letrarë të etapës së parë dhe të dytë të emigracionit të vendosur në Amerikës, ndërkaq veprimtarinë e tyre letrare dhe studimore e zhvilluan edhe Petër Prifti, Nexhat Peshkëpia, Xhevati Kallajxhiu, Arshi Pipa, Bilal Xhaferri, etj., si brez që i takon një periudhe të caktuar të letërsisë shqipe që u krijuat në Amerikë, përkatësisht etapës së tretë të emigracionit shqiptar, të vendour në SHBA pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Ndërsa pas viteve nëntëdhjetë, kur edhe ra diktatura komuniste në Shqipëri, për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia mësynë edhe një numër i madh krijuesish, artistësh e të tjerë, të cilët përpos punëve të tjera që iu duhen për të mbajtur familjen, vazhduan veprimtarinë e tyre letrare. Ata, përveç librave të ndryshëm poetikë, shkruan dhe botuan edhe libra në fushën e prozës, por edhe të gjinive të tjera letrare, por nxorën në dritë edhe revista dhe gazeta, në faqet e të cilave shpalosën apo shpalosin botën e tyre krijuese.

Në mesin e tyre krijuesve që sot i bëjnë nder jo vetëm letërsisë shqiptare që krijohet në diasporë, por edhe asaj të gjithmbashme, janë: Abdurrahman Thaçi, Adnan Mehmeti, Agim Baceli, Albana Liftchin, Alfred Lela, Ani Gjika, Artan Fili, Bardhyl Mezini, Betim Muço, Blerta Alikaj, Dalan Luzaj, Dedë Shkurti, Dhori Thanasi, Donika Timko, Edmond Ismailati, Ejvis Maria Xhajanka, Fatbardha Pali, Fatjon Paja, Fotjon Thanasi, Gazi Buxheli, Gentian Blaca, Gjeto Turmalaj, Gjekë Marinaj, Ilir Levonja, Ilir Borova, Iliriana Sulkuqi, Julia Gjoka, Kolec Traboini, Këze (Kozeta) Zylo, Lekë Gjoka, Lulash Palushaj, Luljeta Blaca, Maksim Zotaj, Mensur Spahiu, Merita Bajraktari McCormack, Mëhill Velaj, Mustafa Elezi, Ndrek Ded Guri, Ndue Hila, Nexhat Imeraj, Nexhip Ejupi, Niko Kirko, Pal Imeri, Pal Ndrecaj, Petraq Pali, Përparim Hysi, Qazim Rushaj, Rajmonda Moisiu, Ramiz Gjini, Roland Musta, Rozi Thehohari, Sami Gjoka, Shpëtim Kastrati, Shqipe Malushi, Tahir Hysa, Vaid Hyzoti, Valbona Dardha,

¹ Historiani Uran Butka dallon tri etapa të emigracionit shqiptar drejt Amerikës: të parën që fillon nga fundi i shek.XIX dhe mbaron në vitin 1920, me rikrijimin e shtetit të pavarur shqiptar; etapën e dytë që përfshin periudhën midis dy luftërave botërore dhe etapën e tretë që përfshin periudhën pas Luftës së Dytë Botërore.” (Butka, Uran, 2012). Unë mendoj se këtu kemi edhe etapën e katërt, e cila përfshin kohën pas rënies së komunizmit në Shqipëri dhe të hapjes së mundësive për një emigrim ekonomik, kulturor etj.

Valentina Gorvokaj, Valter Kozma Lazëri, Yllka Nika, Zef Përgega, Zeqir Gërvalla, Shpend Gjoci, Zera Bajgora etj.

Siq shihet, lista e krijuesve shqiptarë në SHBA është mjaft e gjërë. Për këtë arsyе ajo që shkruhet dhe btohet nga kjo bashkësi krijuesish, shumica të mbledhur rrëth Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, e meriton të quhet letërsi e shqiptarëve të Amerikës dhe e cila ia vlen të trajtohet dhe të studiohet në shumë aspekte. Ajo është një letërsi e cila dita-ditës po merr fizionominë e saj serioze. Autorët e kësaj periudhe i takojnë etapës së fundit, përkatesisht etapës së katërt të emigracionit shqiptar të vendosur në SHBA, përkatesisht mërgatës shqiptare të ardhur pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri (vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar e këndej).

Rrjedhat e zhvillimit të poezisë shqipe në SHBA

Në punimin tim nuk do të ndalem te autorët e etapës së parë e as të dytë, as të tretë, ngase për ta, pothuajse është shkruar e vazhdon të shkruhet madje janë bërë botime, ribotime, por edhe studime nga më të ndryshmet. Unë do të ndalem tek brezi i fundit, i atyre që në SHBA u vendosën pas viteve 90-të, shumica prej të cilëve afirmimin e tyre e kanë përjetuar në atdhe, ndërkaq, me rastin e emigrimit të tyre në këtë vend, pasionin e të marrit me letërsi, ndonëse më ndërprerje dhe vështirësi të shumta, e kanë vazhduar këtu.

Ata kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë si dhe të botojnë vepra të rëndësishme për komunitetin shqiptar, por edhe për letërsinë shqipe në përgjithësi. Mirëpo, ka krijues, të cilët, për shkaqe të ndryshme, nuk kanë pasur mundësinë e zhvillimit të talentitë të tyre letrar në atdhe, qoftë për faktin se u larguan nga atdheu në kohën kur shpërthimet e tyre në këtë fushë nuk kishin ndodhur ende, apo edhe për shkak të pamundësive të tjera për të ndodhur një gjë e tillë në atdhe.

Në poezinë e poetëve shqiptaro-amerikanë dominojnë pothuajse dy tema kryesore: tema e mërgimit dhe ajo patriotike. Mirëpo kohëve të fundit ky shablon tematik sikur ka filluar të tejklohet, ndërsa tashmë poezia duket sikur universalizon sensin poetik, duke zgjeruar kufijt e dialogimit, formësimit por edhe të përcimit të mesazhit poetik, që vjen edhe deri te pasurimi i gamës së tyre jo vetëm në aspektin tematik, por edhe stilistik.

“Në vëllimet poetike të autorëve shqiptarë që krijojnë në SHBA, shohim se preken tema ngajeta, nga filozofia dhe nga përvojat personale, të cilat sublimohen, në rastet më të suksesshme me një gjuhë që është pothuajse ekuivalente me atë të komunikimit të përditshëm, duke thyer monotinë e shprehjes së uniformuar e standarde dhe të përdorimit të figurës poetike si qëllim në vete” (*Ndrecaj, 2010*).

Në diasporën shqipe të Amerikës ka edhe zëra të rëndësishëm poetikë, krijimet e të cilëve po zgjojnë kërshérinë e lexuesve shqiptarë në mërgatë, por edhe më gjërë. Të tillë mund të konsiderohen Aulona Goxha, Ilir Lazim Spata, të cilët “përfaqësojnë dy metoda krejtësisht të ndryshme shkrimi: e para, Aulona Goxha, ndjek rrugën e vargëzimit modern me premisa te theksuara që karakterizojne shkollën që cilësohet nga emërtimi “post”, duke kultivuar tipin e lirikës refleksive, filozofike e intime, ndërsa i dyti, Ilir Lazim Spata ndjek një rrugë të trasuar dekada me parë, natyrisht, me sukses, nga pararendesit e brezave tanë, si De Rada, Koliqi e Fishta: pra, rrugën e epikës heroike e legjendare.

Këta dy krijues mund të thuhet se shënojnë kohën tonë krijuese në SHBA me të veçantat e saj” (*Ndrecaj, 2010*). Ndërkaq, krijues dhe krijuese mjaft interesante dhe me mjaft e njohur për komunitetin shqiptar në SHBA, janë edhe Iliriana Sulkuqi, Rita Salihu, Merita Bajraktari McCormac, poezitë e të cilave, siç shprehet poeti dhe studiuesi Pal Ndrecaj ”janë një gatim ndërmjet fryshtimeve poetike që karakterizojnë poezine tonë të viteve 30 dhe fryshtimeve të kohës së konsolidimit të modernës” (*Ndrecaj, 2010*).

Ndërkaq, emrat të cilët po dëpërtojnë me mjaft sukses jo vetëm në mesin e komunitetit shqiptaro-emerikanë, poezia e të cilëve krijues i bën konkurencë poeziës më të mirë që krijuhet edhe në Shqipëri dhe Kosovë, janë pa dyshim Gjekë Marinaj, Pal Ndrecaj, Adnan Mehmeti, por edhe të tjerë. Natyrisht se lista e poetëve shqiptaro-americani, siç e pamë edhe më lart është shumë më e gjatë, megjithatë në këtë shkrim do të fokusohemi në tre prej tyre. Gjekë Marinaj, Pal Ndrecajn dhe Adnan Mehmetin.

I pari, është një nga poetët më të afirmuar në diasporën shqiptare në Amerikë, i cili ka depërtuar edhe në letërsinë amerikane, ndërkaq, i dyti, një nga emrat e njohur, i cili para se emigronte në SHBA kishte botuar dy libra në Kosovë. Pra ishte afirmuar në Kosovë dhe vazhdon aktivitetin e tij letrar edhe në Nju Jork. Ndërkaq, i treti, Adnan Mehmeti, është një zë intersant dhe mjaft produktiv në jetën letrare të shqiptarëve të Amerikës. I pari, Gjekë Marinaj, është themelues i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, ndërsa i treti, Adnan Mehmeti aktualisht është president i shoqatës në fjalë, e themeluar nga i pari, Marinaj. Që të tre këta poetë shquhen për talentin dhe prurjet e tyre në poezinë më te re shqipe që krijuhet në SHBA.

Natyrmëria poetike e Gjekë Marinaj

Poeti shqiptaro-americani, Gjekë Marinaj është një poet universal, ku dijenia e jetës dhe artit jepin bashkë pamjen më të përkyer të krijimtarisë. Ai po sfidon emrat më të mëdhenj të poeziës bashkëkohore amerikane duke tronditur formalitetin poetik dhe format tradicionale të

të shkruarit me librin e tij të fundit “Lutje në ditën e tetë të javës” (*Buçpapaj*, 2014). Poezia e këtij poeti, i cili në një rast është quajtur më tepër se poet (*Mehmeti*, 2008) është një poezi mjaft autentike, mishërim i invencionit, i mundësive të pafundme të sintezave associative. Apo poezi e gërshetimit të nuancave të ndryshme të të shprehurit, elementet diskursive dhe imagjinatën e frytshme e të paanë.

Poezia e Marinajt është vlerësuar dhe vazhdon të vlerësohet lart. Studiuesja Senada Demushi, e cila ka bërë një monografi për poezinë e Marinajt, duke iu referuar vlerësimeve të kritikës, në mes tjerash veçon: “Kritika bashkëkohore, vlerat ideo-estetik të vargut të Gjekës i vendos në të njëtin nivel me ato të Martin Camajt, Frederik Reshpjes, Dritëro Agollit e shumë lirikëve të tjerë, të cilët janë vlerësuar me dhjetëra e qindra herë. Poetikën e Marinajt e karakterizon një lirizëm i fuqishëm dhe natyrshmëri e thellë poetike” (*Demushi*, 2016).

Ndërkaq, poeti dhe studiuesi Anton Çefa gjatë analizës së njërit nga librat e Marinajt, në mes tjerash shprehet se “fjala në poezinë e Marinajt është ngjyrë, tingull, ide... (*Çefa*, 2001). Sipas Çefës, poezia e Gjekë Marinajt ka ngjyrë të theksuar të ndjenjës, tingull të veçantë, të harmonishëm e melodioz, që i jepin asaj një ngarkesë të fuqishme ideore emocionale, shpesh befasuese” (*Po aty*).

Duhet thënë se poezia e Marinajt është një poezi me vlera të theksuara dhe të dëshiruara poetike. Ajo është një poezi e “pajisur” me një figuracion të mjaftueshëm stilistik, dhe e dominuar nga një frazë e zgjedhur poetike, stil letrar magjepës, ruajtje me fanatizëm të vazhdimësisë së poezisë së mirëfilltë letrare (*Demushi, Anila*, 2016). Poezia e Marinajt është përkthyer edhe në anglisht dhe ka thyer kufijtë e leximit vetëm në shqip. Ajo tashmë është e pëlqyer edhe nga ana e lexuesit amerikan, ku Marinaj tash e sa vite vazhdon të japë kontributin e tij edhe në fushën e arsimit universitar në SHBA.

Pal Ndrecaj poet i një përjetimi të veçantë

Një krijues mjaft produktiv dhe me sharm të theksuar poetik, i cili në kohë të fundit iu ka përkushtuar edhe prozës, është edhe Pal Ndrecaj. I mërguar në SHBA në vitin 2004, si një poet i afirmuar edhe në Kosovë para se të arrinte në Amerikë, në asnjë moment nuk e ndaloi pasionin e të shkruarit poezi. Poezia e këtij krijuesi shqiptaro-amerikan është karakteristike si për nga aspekti i konceptimit të botës dhe dukurive të saj, po ashtu edhe për nga ana e formës dhe mjeteve të realizimit të saj, përcimit të mesazhit poetik dhe artistik etj. Poezia e Palit është një poezi e imazheve dhe figuracionit të qëlluar dhe të formuluar mirë. Duke lexuar poezitë e këtij poeti, lexuesi ndjen kënaqëi por edhe një përjetim të veçantë. Në poezitë e këtij poeti dominon ndikimi i botës dhe filozofisë biblike.

Prandaj, i ndikuar nga një filozofi e tillë poeti shpesh niset nga një fenomen i tillë artistik dhe njerëzor, dukë pasur parasysh atë që quhet krijim jetësor. Madje njëri nga librat e tij mban titullin “Akti i krijimit”. Trinia poetike e poetit Ndrecaj është Poezia-Dashuria-Atdheu. Dy të parat, pra Poezia dhe Dashuria, përbëjnë Atdheun poetik dhe kombëtar të poetit. Në poezinë e këtij poeti shpirti është një sinonim i pastërtisë dhe dinjitetit njerëzor, universal, që paraqet një nga afilozofemat poetike të këtij krijuesi, për të cilin poezia është një planet i pashtershëm, pa të cilin nuk jetohet dhe për të cilin ai është i gatshëm të vdesë në çdo kohë.

Kjo “gatishmëri” poetike e Ndrecajt të kujton një nga poetët më të mirë të Kosovës dhe të poeziës shqipe në përgjithësi, Azem Shkrelin. Duhet theksuar se poezia e Pal Ndrecajt, qoftë në libra dhe krijime të veçanta, qoftë në tërësinë e saj në del një poezi e një përjetimi të veçantë të realitetit historik dhe konkret. Ajo është një poezi e shqetësimeve dhe e depërtimeve të thella në psikologjinë e individit dhe të kolektivit, që shoqërohet nga fatkeqësitetë njerëzore e kombëtare. Poezia e shqiptaro-amerikanit Pal Ndrecaj është një akt i veçantë krijimi, e cila karakterizohet ngashumë aspekte e në veçanti nga aspekti artistik i formulimit dhe i ndërtimit të saj (*Muhadri, 2003*).

Poeti i ndriçimit të enigmave shpirtërore

Adnan Mehmeti është njëri ndër ata poetë shqiptarë, i cili afirmimin e tij në fushën e letrave do ta arrijë në mërgim, përkatësisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Poezia e Adnan Mehmetit, është një poezi mirë e konceptuar dhe me një mesazh të qartë. Ajo është një poezi me një gjuhë të zgjedhur dhe shprehje koncize. Kjo poezi është së tij ia shton vlerat, duke e bërë atë një poezi të meditimit dhe të frymëzimit, por edhe të konceptimit dhe të përcimit të mesazhit artistik në kohë të caktuar dhe tek subjekti i caktuar.

Duke qenë një poet që jeton larg atdheut, por edhe një poet me talent, të cilin ka arritur ta zhvillojë në vazhdimësi, Adnan Mehmeti është shumë i kujdesshëm që para lexuesit të servojë një poezi të brumosur nga një figuracion i pasur stilistik me një mbizotërim të dukshëm të metaforës, krahasimit, epitetit etj. Poezia e Adnan Mehmetit, që nga botimi i vëllimit të parë, ka përjetuar vlerësimë pozitive. I pari ndër ata që shkruan për poezinë e Adnan Mehmetit është kritiku dhe njohësi i mirë i poeziës, Adriatik Kallulli, i cili tek poezia e Adnan Mehmetit sheh talentin por edhe zhvillimin gradual dhe të sigurt.

Mirëpo kritiku tek poezia e Adnan Mehmetit sheh edhe premisa të tjera, elemente që ia shtojnë vlerat e saj dhe e bëjnë atë një poezi të një niveli të qëndrueshëm poetik. Po ashtu gjatë botimeve të mëvonshme pasuan edhe vlerësimet e tjera, që flasin për një poet me premisa të dukshme poetike dhe artistike. (*Muhadri, 2013*)

Orvatje serioze të lëvrimit të prozës

Në fushën e prozës, si në atë të tregimit, po ashtu edhe të romanit vërehen përpjekje serioze të autorëve, të cilat duhet konsideruar si mjaft interesante dhe të cilat duhet të merren në shqyrtim. Përderisa tregimi duket se ka me shumë gjasa për t'u lëruar, romani është një gjini e cila lërohet më pak, apo edhe ato pak romane që botohen kanë një nivel të dëshiruar artistik. Megjithatë duhet veçuar prozën e Ramiz Gjinit, të Pal Ndrecajt, Pierre Pandeli Simisisë, Pjetër Jakut etj. Autor i disa librave, Ramiz Gjini pa dyshim është një nga autorët me interesant dhe më serioz në fushën e prozës, në të cilën rezatoni një nostalgji të pafund për kohë e vende të lashta e të munguara. Ndjesitë e tij të pashmangshme e të fuqishme prej aktori dhe shkrimtari, përcillen përmes një sensibilizimi të personazheve vdekatarë. Shkrimtari Gjini “ka zotësinë të shpërndajë e të sjellë në masa të sakta gjithë elementët e një tregimi modern, brenda te cilit, nuk mungon as melankolia, as humori, as sarkazma dhe as mençuria popullore.

Subjektet nuk janë aspak spektakulare, por vijnë si produkt i jetës së përditëshme e rreale, anipse dramatike të fshatit” (*Dobrescu, Marius, 2009*). Ndërkaq, romani "Rrëketë" i këtij shkrimtari është cilësuar si proza më e thjeshtë, më zbavitëse në dukje të parë, por njëkohësisht edhe si proza më e koklavitur për nga hierarkia shumështresore e realiteteve që ndërton, ndërlidh dhe ndërfut në bashkëveprim të ndërsjelltë. Në këtë kuptim, si një roman i etiketueshëm edhe si një roman antiepopë, ai shfaqet si një kostum tejet origjinal në letërsinë shqipe.

Një krijues tjetër, i cili krahas poezisë po lëron me mjaft sukses edhe przoën, është edhe Pal Ndrecaj. Romani i Ndrecajt, me një titull provokativ “Lista e zezë”, është një roman mbi zhvillimet aktuale politike në Kosovën e pasluftës, ku gara për pushtet del jashtë konturave të veprimit politik, duke mos kursyer mjete ekstreme, të cilat marrin jetë njerëzish. Një roman me plot skena rrëqethëse, që zënë fill në tavolinat e zyrave të partive politike dhe përfundojnë në rrugë, nën tyta pushkësh vëllavrasëse. Prapaskenat, intrigat, shantazhi politik, krimi dhe përpjekja për ta fshehur atë e për t'ia hedhur rivalit politik, përbajnjë fabulën e këtij romani, që është një fabulë e zgjedhur me mjeshtëri, e cila e mban lexuesin pranë vetes gjatë gjithë kohës dhe i mbetet në kujtesë si një ngjarje e përjetuar.

Në fushën e romanit shquhen edhe Pjetër Jaku, Pandeli Simsia etj, ndërsa, po ashtu, edhe proza tregimtare po karakterizohet nga të njejtat veçori dhe karakteristika sikurse edhe romani. Mirëpo, duke qenë një formë shkrimi më e shkurtër, tregimi i shpëton të papriturave të rrugës së gjatë e të mundishme të thurjes dhe bëhet një brum që gatuhet dhe merr formë më lehtë. Edhe në këtë fushë veçohet Ramiz Gjini, por edhe krijues të tjerë si: Mëhill Velaj, Fatjon Pajo, Pëllumb Kulla etj.

Përfundimi

Shqiptarët e Amerikës në këtë kontinent dhe shtet të largët, tashmë përbëjnë një komunitet të organizuar jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në atë të kulturës e në mënyrë të veçantë atë të letërsisë. Duke qenë një komunitet me një traditë mbi njëqindjeçare ekzistimi dhe veprimi në kontinentin e largët, apo në Tokën e lirë, siç dëshirojnë ta quajnë shtetin amerikan, shqiptarët tashmë kanë krijuar edhe një letërsi të mirë, ku emra të njojur defilojnë në kuadër të kësaj letërsie, e cila me kuptimin më të plotë mund të quhet si letërsi e shqiptarëve të Amerikës.

Ata kanë edhe Shoqatën e tyre të quajtur Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-amerikanë, në kuadër të së cilës vepron pjesa dërrmuese e krijuesve që veprojnë dhe jetojnë në SHBA. Po ashtu kanë edhe revistën e vet, si organ i kësaj shoqate. Janë me dhejtra vepra që botohen gjatë një viti nga autorët shqiptarë të kësaj pjese të konitnentit. Siç u pa edhe gjatë shtjellimit të kësaj teme, krijuesit shqiptaro-amerikanë shquhen në fushën e poezisë, prozës por edhe të publicistikës.

Tematika e krijimeve të këtyre shkrimtarëve, qoftë në prozë, qoftë në poezi është mjaft e larmishme, por e dominuar nga malli për atdheun, që është shumë e natyrshme. Disa nga veprat e autorëve shqiptaro-amerikanë, për shkak të nivelit të tyre kw kënaqshëm artistik, janë përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe ashtu si vetë krijuesit, edhe veprat e tyre po integrohen në letërsinë e Amerikës. Kjo është një punë e mbarë dhe një kumt i mirë për letërsinë shqiptarë që krijohet në pjesë të kontinentit dhe shtetit amerikan, por edhe e integrimit të kësaj letërsie në letërsinë e gjithëmbarshme shqipe.

Bibliografia

- BUTKA, Uran (2012). Gazeta “Dielli” 17 Nëntor.
- META, Beqir (2002) “Federata pëndshqiptare “Vatra”.
- NDRECAJ, Pal (2010). *Shkrimi shqip në SHBA dhe gjasat e tij*, Zemra shqiptare, 20 Maj.
- BUÇPAPAJ, Mujo (2008). “E veçanta e poezisë së Gjekë Marinajt”, “Gazeta demokratike”.
- MEHMETI, Adnan (2005). “*Gjekë Marinaj më tepër se poet*”, “Adriatic Press”.
- DEMUSHI, Senada (2016). “*Shtigjeve letrare të Gjekë Marinajt*”, “Nacional, Tiranë.
- PRIFTI, Peter (2003). “*Mozaik shqiptar*”, “Buzuku”, Prishtinë.
- ALIBALI, Agron (2016). “*Dritëhijet e një diplomati*”, LMG, Tiranë.
- MUHADRI, Besim (2003). “*Vështrime letrare, “Bogdani”*”, Has.
- MUHADRI, Besim (2013). “*Përmasa e krijimit*”, “Bogdani & Adriatic Press”, Prizren – Nju Jork.